

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË LEZHË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Bashkinë Lezhë, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.12.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 42, datë 29.04.2016

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1105/10 datë 30.04.2016, i ka rekomanduar z. Fran Frrokaj, Kryetar i Bashkisë Lezhë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nuk kanë gjetur zbatim 2 rekomandime të KLSH, sipas shkresës nr. 266/8, datë 24.01.2012, konkretisht:

-Klubi Sportiv Besëlidhja Lezhë nuk ka ndalur vlerën **5,602,440 lekë** pagesa tepërta, e cila nuk ka shpresë arkëtimi, pasi ish-sportistët nuk kanë marrëdhënie kontraktore me KS Besëlidhja. Kështu nga 5,936,820 lekë gjithsej janë ndalur vetëm 334,380 lekë dhe nuk janë ndalur 5,602,440 lekë.

-Bashkia Lezhë nuk ka kryer ndalesa për subjektet “U...S” për vlerën **201,596 lekë** dhe N.SH. **500,000 lekë** tatim mbi ardhurat.

Rekomandimi: Bashkia Lezhë të ndjekë të gjitha hapat ligjore të mundshme për zbatimin e detyrave të paralizuar të lëna më parë, me qëllim arkëtimin e vlerave **201,596 lekë** nga subjekti “U...S” shpk, **500,000 lekë** nga N.SH. dhe **5,602,440 lekë** nga sportistët e KF “*Besëlidhja*” Lezhë, sipas shkresës të KLSH nr. 266/8, datë 24.01.2012 “*Për zbatimin e rekomandimeve*”.

Brenda muajit Qershor 2016

2. Gjetje nga auditimi: U konstatua se *detyrimet e prapambetura* ndaj të tretëve deri me datë 30.11.2015 në Bashkinë Lezhë, paraqiten për vlerën **341 milion lekë**, e cila do të rëndojë në buxhetin e vitit 2016 krahas likuidimeve të radhës. Detyrimet e prapambetura të pa likuiduara përbëhen nga këto zëra analitikë, sa vijon:

- vlera **197 milion lekë, fatura të pa likuiduara të bashkisë dhe ish-9 komunave për shpenzime operative dhe investime,**

- vlera **144 milion lekë, shpronësime nga investimet publike, vlerë e pa kontabilizuar çka do të jetë objekt sistemimi në mbylljen e bilancit vjetor 2015.**

Rekomandimi: Bashkia Lezhë për vitin 2016 të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën **341 milion lekë**, përkatësisht 197 milion lekë (*fatura të pa likuiduara për shpenzime operative dhe investime të bashkisë dhe ish-9 komunave*) dhe 144 milion lekë (*shpronësimet nga investimet publike, të cilat të kontabilizohen dhe sistemohen në mbylljen e bilancit vjetor 2015*), duke marrë këto masa: reduktimin e shpenzimeve, rritjen e të ardhurave vendore, mbledhjen e arkëtimin e debitorëve, kërkimin e çeljes së fondeve nga qendra sipas burimit financimit të investimeve të kryera si dhe të shikojë çdo mundësi tjetër me miratim të

KB, me qëllim që të shlyej borxhin publik (*detyrimet e prapambetura*) ndaj të tretëve për të evituar kështu dhe kamat vonesat.

Brenda vitit 2016

3. Gjetje nga auditimi: U konstatua se nxjerrja jashtë përdorimi të makinës Benz me targa LE 3731 A të policisë bashkiake, sipas procesverbalit propozues datë 30.12.2012 të komisionit me specialist të fushës, paraqet parregullsi ligjore, pasi: **nuk janë çregjistruar targat e Benzit** pranë NSHTRR Lezhë, madje targat e makinës të asgjësuar janë përdorur për automjetin tjetër tip “*Musso*” si dhe nuk disponohet fletëhyrja për skrapin dhe pjesët këmbimit nga çmontimi dhe fletëdalja për shitjen e tyre, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në shtet dhe sektorit publik*”.

Rekomandimi: Bashkia Lezhë të çregjistrojë targat e Benz-it të asgjësuar LE3731A pranë NSHTRR Lezhë dhe të heqë këtë targë nga automjeti privat “*Musso*”.

Brenda muajit Prill 2016

4. Gjetje nga auditimi: Në kërkesat për kualifikim të paraqitura në formatin elektronik, nga Njësia e Prokurimit, në disa raste, nuk është kërkuar, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të paraqesin:

-Vërtetim për shlyerjen e taksave e tarifave vendore në njësitë vendore ku kryejnë veprimtarinë.

-Numrin e nevojshëm të punonjësve, të dokumentuar nga organet tatimore me listë pagesat e sigurimeve shoqërore.

-Bilancet dhe pasqyrat financiare për 3 vitet e mëparshme.

Rekomandimi: Nga Njësia e Prokurimit në çdo rast në dokumentet e tenderit duhet të kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të plotësojnë kërkesat për kualifikim sipas kërkesave ligjore.

Në Vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në dosjet e tenderit “*Blerje karburanti për vitin 2015*” nuk ka asnjë dokument që të tregojë dhe argumentojë nevojat për karburant, çmimin e marrë për bazë dhe përcaktimin e fondit limit, specifikimet teknike dhe karakteristikat fiziko-kimike të karburantit dhe sasinë e karburantit, të nevojshëm.

Në tenderin “*Blerje artikujve ushqimorë për çerdhe, kopsht dhe konviktin për vitin 2015*” nuk është përcaktuar sasia e ushqimeve pasi nuk ka argumentim të llogaritjes së sasive të artikujve ushqimorë me numrin e fëmijëve dhe të nxënësve që frekuentojnë kopshtet, çerdhet dhe konviktin dhe të normës ditore të ushqimeve. Nga Njësia e Prokurimit fondi limit është llogaritur mbi bazën e kërkesës për artikuj ushqimorë të paraqitur nga magazina e ushqimeve, pa llogaritje konkrete.

Për sa më lart mban përgjegjësi Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, pasi ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” Kreun VII neni 59.

Rekomandimi: Për një përdorim me efikasitet të fondeve publike të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me përcaktimin me përgjegjësi dhe nga persona kompetentë të sasive që do të prokurohen, me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen dhe të përcaktohen hollësisht specifikimet teknike, në zbatim të nenit 59 kreu VII “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, miratuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

Në Vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore konstatohet se deri në datën 31.12.2015 rezultoi se për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë **debitorë** subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh, në vlerën prej **11,633,258 lekë**. Në vlerën e mësipërme për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël në vlerën 3,562,430 lekë, ku 775,358 lekë i përkasin vitit 2014 dhe 2,78,072 lekë i përkasin vitit 2015, si dhe debitorët e biznesit të madh për detyrimet e taksave e tarifave vendore në vlerën 8,070,828 lekë, ku 3,694,578 lekë i përkasin vitit 2014 dhe 4,376,250 lekë i përkasin vitit 2015.

Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Lezhë, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë të pa arkëtuara deri më datën 31.12.2015 në vlerën **11,633,258 lekë**.

Brenda vitit 2016

7. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013 dhe 2014, *Inspektorati ndërtimor* ka punuar në kundërshtim me nenin 82, pika 4, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “*Për planifikim e territorit*” dhe nenin 52 pika 1, germa ‘c’, e ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikim dhe zhvillimin e territorit*”, pasi për rastet e konstatimit “*Mos deklarimi i punimeve që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje*”, nuk janë aplikuar gjoba, kërkesë kjo e nenit 41 të ligjeve të sipërcituar. Njëkohësisht nuk është arkëtuar nga subjekti 2T për 100,000 lekë.

Rekomandimi: INUV për të gjitha rastet e konstatuara dhe të dokumentuara në procesverbale, “*Mos deklarimi i punimeve që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje*”, të merren masa administrative me gjobë, sipas kërkesave ligjore dhe njëkohësisht të arkëtohet edhe *gjoba* e pa likuiduar nga *subjekti 2T* për **100,000 lekë**.

Brenda muajit Prill 2016

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Klub futbollit Besëlidhja njësi vartëse e Bashkisë Lezhë, rezultuan probleme të përsëritura për shpenzime të pa ligjshme, çka bën të domosdoshme riorganizimin e tij ose kalimin nën administrimin e bashkisë.

Rekomandimi: Bashkia Lezhë, të rishikojë problemet e Klub futbollit Besëlidhja, mundësinë riorganizimit ose kalimin nën administrimin e saj (*jo si njësi vartëse*), për efekt të miradministrimit dhe rritjes ardhurave saj.

Brenda muajit Prill 2016

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Lezhë gjatë vitit 2013 ka zhvilluar disa procedura prokurimi të llojit “*Procedura me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës*” ku nuk janë argumentuar dhe dokumentuar shkaqet e përdorimit të procedurës, sipas kërkesës së VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar, kreu IV “*Llojet dhe përzgjedhja e procedurës*”, pika 5, germa “a” duke shmangur procedurat e hapura në rrugë elektronike, shmangur konkurrencën, diskriminuar pjesëmarrjen e kandidatëve të tjerë, çka ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit.

Rekomandim: Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa për zhvillimin e proceduarve të rregullta të prokurimit në rrugë elektronike në portalin e APP, duke krijuar kushtet për pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomikë nxitjen e konkurrencës dhe shmangien e diskriminimit .

Në Vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga Autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, në disa procedura prokurimi viti 2013 nuk është kryer analizimi dhe dokumentimi i kostos së mallrave që do të prokurohen, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, ndryshuar, Kreu II, pika 2, Llogaritja e vlerës së kontratës, germa”ç”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreun VII neni 59.

Rekomandim: Autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, para fillimit të procesit të prokurimit të marrë masa për analizimin e kostos së mallrave punëve dhe shërbimeve që do të kryhen, të përcaktojë specifikimet teknike dhe të kryej dokumentimin e tyre në zbatim të neni 59 kreu VII “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në Vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, njësia e prokurimit në vendosjen e kriterëve të veçanta në DST, ka aplikuar kushte të cilat kanë kufizuar pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë, të cilat bien ndesh me parimet e prokurimit publik, neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” pika”c”e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për Prokurimin Publik”. Këto kushte kanë skualifikuar operatorët, nuk kanë siguruar mirë përdorimin e fondeve publike dhe uljen e shpenzimeve procedurale, duke krijuar mos efektivitet të përdorimit të fondeve publike.

Rekomandim: Autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë të marrë masa për vendosjen e kriterëve të qarta, jo diskriminuese në DST, duke krijuar mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë, nxitjen e konkurrencës si kërkesa të prokurimit publik të përcaktuara në pika 2, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik”.

Në Vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Lezhë, në miratimet e strukturave organike të administratës për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nuk ka parashikuar strukturë të veçantë për administrimin, inventarizimin, gjendjes faktike dhe mbledhjen e të ardhurave nga kontratat e qirave të aseteve në administrim të Bashkisë, e cila është në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, pika 9.

Rekomandim: Bashkia Lezhë, në krijimin e strukturës organike të administratës për vitin 2016 të krijojë strukturë të veçantë për administrimin, inventarizimin e pronave, për vlerësimin e gjendjes faktike të tyre dhe mbledhjen e të ardhurave nga kontratat e qirave të pronave të Bashkisë Lezhë.

Brenda muajit Prill 2016

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Lezhë, nuk ka përfunduar vlerësimin faktik të pronave të listuar me tek VKM nr. 414, datë 11.7.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Lezhë të Qarkut të Lezhës”(291 prona me 59 fletë), transferuar prona shtesë VKM nr. 1686, datë 24.12.2008 “Për një ndryshim dhe shtesë në VKM nr. 414, datë 11.7.2007, (221 pasuri) nga të cilat janë regjistruar 402 pasuri.

Rekomandim: Bashkia Lezhë, të marrë masa për vlerësimin faktik të pronave të transferuara, të shoqëruara me harta, skica dhe dokumenta shoqëruese të tyre duke

bërë inventarizimin fizik mbështetur në Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 11/4 dhe nenin 12/f dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”kap.IV “Sistemi periodik i aktiveve” dhe regjistrimin e tyre pranë zyrës vendore të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) Lezhë.

Brenda muajit Qershor 2016

14. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se disa nga pronat që i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Lezhë me VKM nr. 414, datë 11.7.2007 ”Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Lezhë të Qarkut të Lezhës”, janë zënë nga të tretët dhe nga ana e Bashkisë nuk janë marrë masa për lidhjen e kontratave të qirave apo lirim të tyre, veprime këto në kundërshtim me VKM apo të Këshillit të Bashkisë.

Rekomandim: Bashkia Lezhë, të marrë masa që pronat e kaluara me VKM nr. 414 datë 11.7.2007, të lirohen dhe të vijojë administrimi i tyre, sipas kërkesave të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Brenda muajit Prill 2016

15. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Lezhë nuk ka një kuptim të qartë të menaxhimit të riskut. Nuk ka shkresë zyrtare për caktimin e koordinatorit të riskut nga nëpunësi autorizues i njësisë. Strategjia e risqeve është miratuar por nuk është identifikuar risku sipas nenit 21 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nuk është bashkëpunuar me menaxherët e tjerë të institucionit për krijimin e regjistrimit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ato drejtojnë.

Rekomandim: Bashkia Lezhë, të marrë masa për caktimin e koordinatorit të riskut të njësisë, strategjisë së tij si dhe kryerjen e trajnimit të personelit për një kuptim më të mirë të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” .

Brenda muajit Prill 2016

16. Gjetje nga auditimi: Bashkia Lezhë, për vitet 2013-2015 ka mangësi në inventarizimin e dosjeve të tenderëve dhe arkivimin e tyre, në kundërshtim me udhëzimet e APP-së, me nenin 30 të Modelit nr. 8 “Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Rekomandim: Bashkia Lezhë të inventarizojë dhe të arkivojë dosjet e prokurimit për tenderët e realizuara në periudhën 2013-2015.

Brenda muajit Prill 2016

17. Gjetje nga auditimi: U konstatua se dosjet teknike të investimeve kanë mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 4, paragrafi 4.

Rekomandim: Bashkia Lezhë, nëpërmjet Zyrës së planifikimit të territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Në Vijimësi

18. Gjetje: Dosjet teknike të lejeve zhvillimore rezultuan me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, me VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit” e ndryshuar me VKM nr. 88, datë 07.02.2012, VKM nr. 139, datë 22.02.2012, VKM nr. 345, datë 09.05.2012 dhe VKM nr. 314, datë 13.3.2013.

Rekomandim: Bashkia Lezhë, nëpërmjet zyrës së planifikimit të territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të lejeve zhvillimore.

Brenda muajit Prill 2016

19. Gjetje nga auditimi: Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

Rekomandim: Bashkia Lezhë, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marri masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Bashkia Lezhë, Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka hartuar e miratuar preventiva me zëra punimesh më tepër se sa parashikuar nga VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, duke sjellë për pasojë preventiva jo real, fond limit më të madh se nevoja për investim, dhe përfitim të padrejtë për shoqëritë sipërmarrëse të këtyre shërbimeve.

Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit të Territorit në përgatitjen e projekteve e preventiva të investimeve të veprojë në zbatim të akteve ligjore që rezultojnë në fuqi në kohën e përpilimit të dokumentacionit, apo në kohën e realizimit të investimit në rastet kur kryerja e këtyre dy procedurave nuk përkojnë në kohë ose kur nga njëra procedurë në tjetrën është konstatuar ndryshim i kuadrit ligjor të fushës.

Në Vijimësi

B/1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësisë të sektorit publik” kapitulli IV- Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e Bashkisë Lezhë të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohet në rrugë ligjore **shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën 31,116,980 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: U konstatua 1 rast për vitin 2013 shpenzim i paligjshëm pritje përcjellje për një drekë me rastin 2 marsit “Festa e Kuvendit të Lezhës”, për vlerën **100,000 lekë dëm ekonomik** me pjesëmarrjen e 80 punonjësve të bashkisë me nga 1,250 lekë secili, sipas urdhër shpenzimit nr. 465, datë 13.12.2013, në kundërshtim

me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” të ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999, me pikën 1/b të VKM nr. 472, datë 02.7.2011”Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”.

Rekomandimi: Bashkia Lezhë të arkëtojë vlerën **100,000 lekë** për shpenzim të paligjshëm pritje përcjellje, nga 80 persona të bashkisë me nga 1,250 lekë secili, sipas listës bashkëngjitur urdhër shpenzimit nr. 465, datë 13.12.2013.

Brenda muajit Maj 2016

2. Gjetje nga auditimi: Sipas urdhër shpenzimit nr. 115, datë 12.3.2014 për vlerën **26,000 lekë tvsh** (130,000 x 20 %) është përfituar padrejtësisht nga subjekti “J...U shpk”, pasi në preventiv dhe situacion është llogaritur me gjithë vlerën e TVSH, nuk është ndarë veças vlera e pajisjes pa tvsh dhe veças vlera e pajisjes me tvsh dhe vihet në fund të situacionit.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **26,000 lekë tvsh** (130,000 x 20 %) nga subjekti “J...U shpk”, pasi në preventiv dhe situacion është llogaritur me gjithë vlerën e tvsh, nuk është ndarë veças vlera e pajisjes pa tvsh dhe veças vlera e pajisjes me tvsh, sipas urdhër shpenzimit nr. 115, datë 12.3.2014.

Brenda muajit Maj 2016

3. Gjetje nga auditimi: U konstatua vlera **269,424 lekë dëm ekonomik**, fondi rezervë 3 % është përfituar padrejtësisht nga subjekti “M...I shpk”, pasi kjo vlerë nuk është zbërthyer analitikisht në zëra pune të veçantë, por është mjaftuar me pasqyrimin e vlerës të plotë në preventiv dhe situacionin përfundimtar, çka nuk argumenton se çfarë punimesh janë kryer, sipas urdhër shpenzimeve nr. 84, 85, 87, datë 25.02.2013, nr. 192, datë 8.5.2013 për “Sistemim bllok II banimi pranë lumit Drin ne krah te urës qytetit Faza e pare”.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **269,424 lekë** nga subjekti “M...I shpk”, fondi rezervë 3 %, është përfituar padrejtësisht, pasi kjo vlerë nuk është zbërthyer në zëra pune të veçantë, por është mjaftuar me pasqyrimin e vlerës të plotë në preventiv dhe situacionin përfundimtar, çka nuk argumenton se çfarë punimesh janë kryer, sipas urdhër shpenzimeve nr. 84, 85, 87, datë 25.02.2013, nr. 192, datë 8.5.2013 për “Sistemim bllok II banimi pranë lumit Drin ne krah Faza e pare”.

Brenda muajit Maj 2016

4. Gjetje nga auditimi: Sipas urdhër shpenzimit nr. 203 datë 13.5.2013, nr. 410 datë 19.11.2013, faturës nr. 57 datë 12.01.2013 është shpenzuar vlera **232,200 lekë dëm ekonomik**, për transport dheu dhe mbetje urbane, rezulton se ky shërbim nuk justifikohet, pasi mbulohet nga firma kontraktore. Gjithashtu nuk disponohen dokumenta provë si fotografimi para dhe pas kryerjes të këtij shërbimi, për efekt argumentimi.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **232,200 lekë** nga preventivuesi Ndue Pepa **116,100 lekë** dhe drejtori i shërbimeve z.P.L. **116,100 lekë**, për shpenzim të pa argumentuar, sipas urdhër shpenzimit nr. 203 datë 13.5.2013, nr. 410 datë 19.11.2013, pasi transporti dheu dhe mbetje urbane mbulohet nga firma kontraktore, gjithashtu nuk disponohen dokumenta provë si fotografimi para dhe pas kryerjes të këtij shërbimi, për efekt argumentimi.

Brenda muajit Maj 2016

5. Gjetje nga auditimi: U konstatua se:

-Njësia e prokurimit pa mbështetje ligjore në DST dhe në preventiv, ka përfshirë zërin “Transportin e mbetjeve të diferencuara dhe inerte”, zë i cili nuk përfshihet në Kreun II-të, neni 5 “Mbeturinat” dhe Kreun III të Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”. Për rrjedhojë ky zë nuk duhej përfshirë në preventiv dhe DST, çka ka shkaktuar vlerën **1,468,440 lekë dëm ekonomik** (18,802 leke/muaj x 33 muaj = 620,466 + 847,974 (282,658 x 3 janar-shkurt-mars 2013), sipas situacioneve për vitin 2013, 2014, 2015 bazuar në kontratën e sipërmarrjes nr. 1720, datë 16.9.2011 dhe shtesës saj nr. 799, datë 02.5.2011 me afat 5 vjeçar. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” Kreun II-të neni 6 pika 1-13, neni 5 “Mbeturinat” dhe Kreun III-të dhe IV neni 24 etj. Theksojmë se Bashkia ka pakësuar këtë zë pune për periudhën prill 2013- dhjetor 2015 nga 282,658 lekë në 18,802 lekë, sipas amendamentit nr. 1 dhe nr. 2.

-Supervizori i bashkisë, për 7-mujorin e periudhës Nëntor 2014-Qershor 2015 nuk ka zbritur firmës pastrimit zërin e punës “pastrimi dhe fshirja e sheshit Gjergj Kastrioti te qytetit”, për sipërfaqen 3,522 m², pasi sheshi i është nënshtruar rikonstruksionit me tenderim. Për rrjedhojë nga përllogaritjet rezulton se firma e pastrimit “I...I & K...I” shpk, ka përfituar tepër vlerën **91,217 lekë** për **punë të pakryer** (3,522 m² x 3,7=13,031 x 7 muaj= 91,217 lekë), në kundërshtim me kontratën nr. 1720, datë 16.9.2011 dhe me nenin 65 të rregullores brendshme të bashkisë miratuar me VKB nr. 35, datë 30.6.2010.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **1,468,440 lekë** nga Njësia e prokurimit N.K, N.P, N.LL. me nga 489,480 lekë për secilin, pasi pa mbështetje ligjore ka përfshirë zërin “Transportin e mbetjeve të diferencuara dhe inerte” në DST, në preventiv, në situacionet e firmës pastrimit 2013, 2014, 2015, kontratën nr. 1720, datë 16.9.2011 dhe shtesën e kontratës nr. 799, datë 02.5.2011.

-Të arkëtohet vlera **91,217 lekë** nga supervizori E.M, pasi ka nënshkruar situacionet për punë të pakryer në zërin “pastrimi dhe fshirja e sheshit Gjergj Kastrioti te qytetit”, ku sheshi i është nënshtruar rikonstruksionit për 7 muaj.

Brenda muajit Korrik 2016

6. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e kontratës së lidhur është bërë blerje karburanti në datën 29.6.2015 për sasinë 3,000 litra me çmimin 147.253 lekë/litër pa TVSH. Çmimi i karburantit i llogaritur sipas bursës Reuter të datës 11.6.2015 dhe marzhin e fitimit të kontraktuar 10.22% është 145.49 lekë/litër, pra me një diferencë 1.763 lekë/litër, që për sasinë 3,000 litra është paguar tepër shuma 5,289 lekë me urdhër shpenzimit nr. 390, datë 16.7.2015. Po kështu në datën 20.11.2015 me faturën tatimore nr. 15 është blerë 11,995 litra karburant me çmim 133.382 lekë/litër pa TVSH dhe marzhi i fitimit është llogaritur 15 lekë/litër pa TVSH, kur sipas kontratës duhej të ishte 10.22%, ose 12.1 lekë/litër dhe çmimi i karburantit duhej të ishte 130.482 lekë/litër, me një diferencë prej 2.9 lekë/litër. Për sasinë prej 11,995 litra, rezulton të jetë paguar tepër 34,785 lekë, të cilat duhet të kthehen nga operatori ekonomik “L...A” sh.p.k.

Rekomandimi: Të merren të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **40,074 lekë**, përfituar padrejtësisht nga Shoqëria “L...A” sh.p.k., si diferencë e çmimit të karburantit të blerë gjatë vitit 2015.

Brenda muajit Korrik 2016

7.Gjetje nga auditimi: U konstatua përfitim i shërbimit të transportit (40,000 lekë/muaj), për vlerën **525,000 lekë dëm ekonomik** përfituar për vitin 2014 nga z. V.T, në kundërshtim me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë” i ndryshuar me ligjin nr. 169/2013, datë 07.11,2013, lidhja nr 2, “ Për përfitimin financiar mujor të shërbimit të transportit për disa funksione publike” , pasi ligji nuk ka miratuar financim mujor për funksionarët me detyrë “Kryetarë të Bashkive”.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera e mbetur **525,000 lekë**, nga V.T, për shpërblim të padrejtë financiar mujor të shërbimit të transportit për vitin 2014.

Brenda muajit Korrik 2016

8. Gjetje nga auditimi: U konstatuan 2 raste me shkelje, për **përfitim të shpenzimeve celulare**, për vlerën **192,000 lekë**, pasi kanë marrë 10,000 lekë në muaj nga 4,000 lekë në muaj që i takon, në kundërshtim me pikën 9, të VKM nr. 864 datë 23.07.2010 “Për pajisjen me telefoni celular të personave juridik e publik “, përkatësisht: 168,000 lekë, përfituar për vitin 2013, 2014 dhe 2015 nga z. V.T. dhe 24,000 lekë, përfituar për periudhën gusht, shtator, tetor, nëntor të vitit 2015 nga z. F.F.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **192,000 lekë**, përkatësisht nga z.V.T. **168,000 lekë** dhe z. F.F. **24,000 lekë**, për shpenzime celulare të përfituara tepër, në vitet 2013, 2014 dhe 2015.

Brenda muajit Maj 2016

9. Gjetje nga auditimi: U konstatua se padrejtësisht janë kryer **pagesa të paligjshme** për disa **Këshilltarë**, të cilët janë paguar edhe për ditët që nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Bashkiak për periudhën 2013, 2014 dhe 2015, çka ka krijuar një efekt financiar në vlerën **558,900 lekë dëm ekonomik**, në mos përputhje me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **558,900 lekë**, pagesa të paligjshme për disa Këshilltarë Bashkisë, të cilët padrejtësisht janë paguar edhe për ditët që nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e KB për periudhën 2013, 2014 dhe 2015.

Brenda muajit Maj 2016

10. Gjetje nga auditimi : Në Klubin e Futbollit “Besëlidhja” për vitin 2013, rezulton se janë përfituar **paga të paligjshme mbi kufirin ligjor** nga disa **futbollistë** me vlerën **855,000 lekë dëm ekonomik**, në kundërshtim me pikën 18 dhe 19 të VKM nr. 586, datë 17.07.2013“Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, date 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësisve qeverisjes vendore dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve qeverisjes vendore”, lidhja 2.

Rekomandimi: Bashkia Lezhë (Klubi Sporti Besëlidhja), të arkëtojë vlerën **855,000 lekë**, pagesa të paligjshme mbi kufirin ligjor për vitin 2013.

Brenda muajit Korrik 2016

11. Gjetje nga auditimi : Në Klubin e Futbollit “Besëlidhja” për vitin 2013 janë përfituar **dieta të paligjshme** nga 43 futbollistë me vlerën **115,600 lekë dëm ekonomik**, pasi dokumenti tatimor nuk shoqërohet me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, nënpika 3.2.

Rekomandimi: Bashkia Lezhë (*Klubi Sportit Besëlidhja*), të arkëtojë vlerën **115,600 lekë**, dieta të paligjshme për vitin 2013, nga 43 futbollistë, sipas pasqyrës të raportit auditimit.

Brenda muajit Maj 2016

12. Gjetje nga auditimi: U konstatua **dëm ekonomik** në shumën **1,418,063 lekë** për tenderin me objekt *"Rikonstruksion i Objektivit 4-katesh në bashkëpronësi sheshi "Besëlidhja" në qytetin e Lezhës"* për procedurën e prokurimit *"Tender i hapur"*, KVO ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik "E...S-M...T" sh.p.k me ofertën më të ulët, me vlerë 7,588,269 lekë në kundërshtim me qëllimin për të cilin realizohet procedura e prokurimit publik, të sanksionuar me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar *"Për prokurimin publik"*, Neni 1 *"Objekti dhe qëllimi"* pika 2.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **1,418,063 lekë**, nga KVO, përkatësisht P.S. 283,612 lekë, B.M. 283,612 lekë, E.N. 283,612 lekë, B.B. 283,612 dhe P.M. 283,612 lekë, për skualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik me ofertën më të ulët, në procedurën e prokurimit *"Rikonstruksion i Objektivit 4-katesh në bashkëpronësi sheshi "Besëlidhja" në qytetin e Lezhës"*.

Brenda muajit Korrik 2016

13. Gjetje nga auditimi: U konstatua **dëm ekonomik** në shumën **2,706,139 lekë** për tenderin me objekt *"Rikualifikim i lulishtes së qendrës së qytetit të Lezhës 2014"*, me procedurë prokurimi *"Procedurë e Hapur"*, pasi KVO ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik "B...S" sh.p.k me ofertën më të ulët, pa arsye nën pretekstin se *"nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme sipas objektivit tonë të prokurimit"* dhe *"vërtetimit të energjisë elektrike"* që në fakt ai i disponon, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar *"Për prokurimin publik"*.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **2,706,139 lekë**, nga KVO, përkatësisht: P.S. 541,227 lekë, B.M. 541,231 lekë, E.N. 541,227 lekë, B.B. 541,227 lekë, P.M. 541,227 lekë, për skualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik "B...S" sh.p.k në procedurën e prokurimit *"Rikualifikim i lulishtes së qendrës së qytetit të Lezhës"*.

Brenda muajit Korrik 2016

14. Gjetje nga auditimi: U konstatua se: subjekti televizioni *"L.S."* nuk ka paguar detyrimin kontraktor të **qirasë** të objektivit *Pallati i Kulturës* pronë e Bashkisë Lezhë, për vitet 2013, 2014 dhe 2015 për vlerën **2,494,800 lekë dëm ekonomik**, sipas kontratave nr. 5/3 datë 04.01.2013 dhe nr. 11 datë 03.01.2014 për marrjen me qira të sipërfaqes 198 m² me detyrim mujor 69,300 leke dhe 831,600 lekë detyrim vjetor, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011, ndryshuar me VKM nr. 54 datë 5.2.2014 *"Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"*.

Rekomandimi: Të arkëtohet dëmi për vlerën **2,494,800 lekë** nga subjekti televizioni *"L.S."*, për detyrim kontraktor qiraje të papaguar të ambienteve të Pallatit Kulturës, pronë e Bashkisë Lezhë, për vitet 2013, 2014, 2015.

Brenda muajit Maj 2016

15. Gjetje nga auditimi: U konstatua se disa subjekte nuk kanë arkëtuar detyrimet kontraktore për qiratë e objekteve të Bashkisë Lezhë, për shumën **342,283 lekë dëm ekonomik**, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011, ndryshuar me VKM nr. 54 datë 5.2.2014 *"Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së"*

dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” si dhe me kontratat sipas përkatësisë.

Rekomandimi: Të arkëtohen detyrimet kontraktore për qiratë e pa paguara të objekteve të Bashkisë Lezhë, për shumën **342,283 lekë dëm ekonomik**, përkatësisht: O...E 124,320 lekë për vitin 2014 dhe 2015, D.J. 30,000 lekë për vitin 2014, A.GJ. 5,600 lekë për vitin 2014, E.H. 78,400 lekë, K.E. 50,400 lekë, “U...I Lezhë” 19,963 lekë dhe E.N. 33,600 lekë, për vitin 2015, në të kundërt të ndërpriten kontratat për shkelje të kushteve të tyre.

Brenda muajit Maj 2016

16. Gjetje nga auditimi: U konstatua mungesë të ardhurash në shumën **260,856 lekë** lekë në Buxhetin e Bashkisë Lezhë si pasojë e lidhjes së kontratave me të drejtë përdorimi, pa shuma qiraje për objekte prona të Bashkisë Lezhë, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011, ndryshuar me VKM nr. 54 datë 5.2.2014 ”*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”.

Rekomandimi: Bashkia Lezhë të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **260,856 lekë**, duke lidhur kontratat e qirasë me subjektet K.R. 47,592 lekë, SH.J. 36,000 lekë, SH.R. 36,000 lekë, D.P.S 36,000 lekë, D.P.D. 36,000 lekë, SH.N.D.NJ. 36,000 lekë dhe SH.V. 33,264 lekë.

Brenda muajit Maj 2016

17. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikualifikimi i Lulishtes së Qendrës*” Bashkia Lezhë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit si dhe nga verifikimi në terren rezultuan, diferenca në volume **pune të pakryera** dhe të likuiduara në vlerën **4,113,386 lekë dëm ekonomik** pa tvsh, nga subjekti “*T...M*” shpk , në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”.

Rekomandim: Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti “*T...M*” shpk, për vlerën **4,113,386 lekë**, për punime të pakryera në objektin “*Rikualifikimi i Lulishtes së Qendrës*” Bashkia Lezhë , sipas kontratës për punë publike me nr. nr. 7670/2, datë 17.12.2014.

Brenda muajit Maj 2016

18. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndriçimi dhe Sistemimi i Rrugës Hyrëse të Lezhës, Segmenti Ura Drinit-Rotondo*” Bashkia Lezhë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit si dhe nga verifikimi në terren rezultuan, diferenca në volume **pune të pakryera** dhe të likuiduara në vlerën **3,059,855 lekë dëm ekonomik** pa t.v.sh nga subjekti “*J...K*” Shpk , në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar.

Rekomandim: Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti “*J...K*” Shpk , për vlerën **3,059,855 lekë**, për punime të pakryera në objektin “*Ndriçimi dhe Sistemimi i Rrugës Hyrëse të Lezhës, Segmenti Ura Drinit-Rotondo*” Bashkia Lezhë, sipas kontratës për punë publike me nr. 2323/2, datë 04.08.201.

Brenda muajit Maj 2016

19. Gjetje nga auditimi: Në lejen zhvillimore “*Godinë Banimi dhe Shërbimi 1-10 kate + 1 kat Podrum (Seksioni B-1)*” Bashkia Lezhë, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi llogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se kjo

është paguar pjesërisht ose nuk është paguar vlera **12,247,743 lekë dëm ekonomik**, në kundërshtim me ligjin nr. 107/204 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46, pika 2.

Rekomandim: Bashkia Lezhë, nëpërmjet drejtorisë planifikimin dhe zhvillimit territorit të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për ti kërkuar shoqërisë “A.V.K.” *shpk*, arkëtimin e taksës së ndikimit të infrastrukturë të papaguar për vlerën **12,247,743 lekë**, për lejen zhvillimore “*Godinë Banimi dhe Shërbimi 1-10 kate + 1 kat Podrum Seksioni B-Lezhë*”.

Brenda muajit Maj 2016

B/2. SHPENZIME NË KUNDËRSHTIM ME PRINCIPET E EFEKTIVITETIT, EFICËNCËS DHE EKONOMICITETIT TË FONDEVE PUBLIKE (3-E).

1. Gjetje nga auditimi: Nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë nuk është argumentuar me hollësi vendosja e kriterëve të kualifikimit në DST, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, po kështu dokumentet e kërkuara për punë të ngjajshme, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, Kreu III, pika 3, germa “a” si dhe nenin 46 të ligjit të Prokurimit Publik pika 3. Vendosja e kriterëve të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet në realizimin e prokurimit. Për rrjedhojë ka shmangur pjesëmarrjen e gjerë të Operatorëve Ekonomik, veçanërisht biznesit të vogël. Për pasojë nga këto veprime, për dy procedura prokurimi, nuk është përmbushur qëllimi kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik neni 1, për mirë përdorimin e fondeve publike, kursimin e tyre, trajtimin e barabartë të operatoreve pjesëmarrës, duke bërë që vlera **6,409,473 lekë fonde buxhetore të mos përdoren me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet** në buxhetin e bashkisë Lezhë.

Rekomandim: Autoriteti kontraktor dhe njëësia e prokurimit të Bashkisë Lezhë, në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit të parashikojë nevojat për prokurim të mallrave apo shërbimeve, të bëjë kujdes në përputhje me kërkesat ligjore zgjedhjen e procedurës së prokurimi, llogaritjen e fondit limit (*argumentimin e vlerës limit të kontratës*) dhe përcaktimin e specifikimeve teknike të veçanta në DST, që të bëjë të mundur që KVO të bëjë një vlerësim objektiv dhe jo diskriminues për operatorët pjesëmarrës në procedurat e prokurimit dhe me leverdi ekonomike për fondet buxhetore.

Në Vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

a. Në objektet “*Rikualifikimi i Qendrës së Qytetit Lezhë*”, “*Rikualifikimi i Lulishtes së Qendrës*” dhe “*Zgjerim i Urës mbi Lumin Drin, Ndriçim dhe Dekorim*” Bashkia Lezhë, rezulton se **janë preventivuar tepër fond limit**, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve krahasuar me manualin teknik të çmimeve dhe rritjes fiktive të volumeve të punimeve krahasuar me projektin e zbatimit të miratuar, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe fushën e prokurimit publik.

b. Në objektin “*Rikualifikimi i Qendrës së Qytetit Lezhë*” Bashkia Lezhë, rezultuan volume **pune të pakryera** dhe të likuiduara në vlerën **22,428,537 lekë**, nga kontrolli i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit si dhe

nga verifikimi në terren, veprime në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit.

Rekomandim: Bashkia Lezhë:

a. të ngrejë komision me specialistë të fushës, i cili të bëjë ri llogaritjen e fondit limit, për zërat e punës që nuk janë hartuar sipas manualeve teknike si dhe të bëjë rivlerësimin e diferencave, bazuar në aktet ligjore të kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit etj, për objektet “*Rikualifikimi i Qendrës së Qytetit Lezhë*”, “*Rikualifikimi i Lulishtes së Qendrës*” dhe “*Zgjerim i Urës mbi Lumin Drin, Ndriçim dhe Dekorim*”, njëkohësisht bashkia të analizojë shkeljet e personave përgjegjës.

b. ti kërkojë BOE “*T.A.L.*” Shpk dhe “*J...K*” shpk, që të realizojë të gjitha volumet e punës së pakryer duke i pasqyruar dhe dokumentuar ato tërësisht.

Në Vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin e tij nr. 485/2014, për procedurën e prokurimit “*Tender i Hapur*” në objektin “*Rikualifikim i qendrës së qytetit të Lezhës*”, ka skualifikuar padrejtësisht BOE “*C...I*” shpk & “*G...I*” shpk, me vlerën më të ulët 150,134,486 lekë dhe i ka dhënë të drejtën e kualifikimit BOE “*T.A.L.*” shpk & “*J...K*” shpk, fitues për vlerën 183,635,094 lekë, çka ka shkaktuar diferencën në vlerën **33,500,608 lekë (183,635,094-150,134,486) mungesë ekonomiciteti të fondeve publike.**

Sipas KPP, BOE “*C...I*” sh.p.k. & “*G...I*” sh.p.k., nuk ka plotësuar kërkesën e veçantë për paraqitjen e “*certifikatave ISO të origjinës, për shtyllat, ndriçuesit dhe kabllot që do të vendosen në objekt*”, kjo nuk qëndron pasi subjekti i ka paraqitur ato. Ky fakt është anashkaluar nga KPP, duke kaluar në arsyetimin e një kontrate tjetër të shoqërisë “*C...I*” sh.p.k. dhe distributorit “*E.C.*” sh.p.k.

KPP ka vepruar me dy standarte në gjykimin e kërkesës së sipërcituar, pasi ka pranuar se BOE “*T.A.L.*” sh.p.k. & “*J...K*” sh.p.k., e cila i ka paraqitur certifikatat, dhe nuk ka pranuar faktin që BOE “*C...I*” sh.p.k. & “*G...I*” sh.p.k. ka paraqitur certifikatat, që në fakt i ka paraqitur madje dhe me ofertë më të ulët ekonomike, çka duhej ti jepte prioritet kësaj të fundit, veprim në kundërshtim me nenin 2 “*Parimet e përzgjedhjes*” pika “c” e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “*Për Prokurimin Publik*”.

Rekomandim: Nxjerrja e shkallës së përgjegjësisë dhe marrja e masave disiplinore për ish-Komisionin e Prokurimit Publik, për shkeljet në vendimin e KPP nr. 485/2014, datë 8.8.2014, në shqyrtimin e procedurës së prokurimit “*Tender i Hapur*” në objektin “*Rikualifikim i qendrës së qytetit të Lezhës*”, do ti kalohet për kompetencë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion pranë Këshillit të Ministrave.

Në Vijimësi

C. MASA ADMINISTRATIVE

I. Nga Bashkia Lezhë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, **t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor** Bashkisë Lezhë, **të vendosë masa administrative me gjobë**, për:

1. 100,000 lekë për Ing. V.G, nën cilësinë e përfaqësueses ligjore të firmës mbikëqyrëse të punimeve OE “P.C.”, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “*Rikualifikimi i Lulishtes së Qendrës së Qytetit Lezhë*” Bashkia Lezhë, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **4,113,386 lekë** pa t.v.sh, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar.

2. 50,000 lekë për ing. ZH.K, nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me “*Rikualifikimi i Lulishtes së Qendrës së Qytetit Lezhë*” Bashkia Lezhë me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **4,113,386 lekë** pa t.v.sh, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

3. 100,000 lekë për Ing. A.P, nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “*Ndriçimi dhe Sistemimi i Rrugës Hyrëse të Lezhës, Segmenti Ura Drinit - Rotondo*” Bashkia Lezhë, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **3,059,855 lekë** pa t.v.sh, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar.

4. 50,000 lekë për ing. I.D, nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës kolaudatore të punimeve “I.-D.” shpk, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me “*Ndriçimi dhe Sistemimi i Rrugës Hyrëse të Lezhës, Segmenti Ura Drinit - Rotondo*” Bashkia Lezhë me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **3,059,855 lekë** pa t.v.sh, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

II. Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në pikën të VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “*Për Licencimin Profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit*” dhe në nenin 13, nenin 25 dhe pika 1/a, 1/e, e nenit 41, Kreu VI-të, “*Sanksione dhe Dispozita kalimtare*”, të “*Rregullores për Kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit*”, për shkelje të ligjshmërisë në zbatimin e punimeve, në fushën e ndërtimit, **i rekomandojmë Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë Zhvillim Urban, heqjen e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim (heqjen e Licencës profesionale), për një afat nga 2-3 vjet,** si më poshtë:

1. Për subjektin “D.-E.”, shpk, me administrator z. B.D, me licencë nr. MK 1713/4, me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit nr. 4112/2 prot, datë 20.10.2014, për shkak se:

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në

terren, rezultojnë diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 22,428,537 lekë pa T.V.SH, mangësi në dokumentacion si dhe problematikat, si më poshtë:

Mangësi në dokumentacion:

-Certifikatat e cilësisë së materialeve: gjeotekstil, çakëll, hekur betoni, rërë, çimento, bordura guri “porfido”, pllaka guri “porfido”, tubo PVC, Tubo PE, kabull FG7OR, bar, humus, fidanë pemësh, fidanë lulësh.

-Provat e cilësisë së betonit të përdorur dhe llaçit, provat e rezistencës së çelikut për realizimin e tyre konform projektit të zbatimit dhe specifikimeve teknike;

-Dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjetet mbrojtëse përkatëse;

-Plan-organizimi i punimeve të ndërtimit;

-Libri i kantierit;

-Pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip;

-Aktet e inspektimeve të kryera gjatë zbatimit të punimeve;

-Mungojnë provat pa ngarkesë lidhur me ndriçimin.

Mangësitë në zbatimin e punimeve:

Konkretisht nga auditimi i kryer rezultoi se janë likuiduar volume **pune të pakryera në vlerën 22,428,537 lekë** pa t.v.sh.

Vlera **22,428,537 lekë pa t.v.sh** si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Kjo vlerë ka ardhur si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera por të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave. Këto veprime janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve, neni 23, pika 23.2 në kontratën me nr. - prot., datë 22.07.2014 të lidhura me operatorin ekonomik “T.A.L.” dhe “J...K” sh.p.k.

Gjithashtu nga mbikëqyrësi i punimeve, Ing. B.D.:

- Nuk është zbatuar ligji nr., 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*” i ndryshuar, dhe konkretisht neni 7 ku përcaktohet se: “*Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit*”.

- Nuk janë marrë masa për zbatimin e Udhëzimit nr. 2 datë 13.05.2005 “*Për zbatimin punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3 ku përcaktohet se: “*Materialet dhe produktet e ndërtimit me standarde të detyrueshme vendosen në vepër kur janë shoqëruar me certifikatë cilësie, me rezultatet e provave dhe të analizave, që vërtetojnë ose vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me standardet, që referohen në përshkrimet dhe specifikimet teknike*”.

- Nuk është zbatuar udhëzimi nr.3, datë 15.02.2001 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, pika 3.2 dhe 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se:

“*3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*”

-Nuk është zbatuar udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e*

punimeve të ndërtimit””, pika 4, paragrafi 4 ku përcaktohet dokumentacioni i nevojshëm në dosjen teknike.

III. Mbështetur në nenin 59 “Ilojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në nenin 72 “Kundërvajtjet administrative” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik “ i ndryshuar, **propozojmë APP (Agjencisë së Prokurimit Publik) dhënien e masave administrative, për KVO dhe njësinë e prokurimit dhe titullarin e Autoritetit Kontraktor,** referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2015, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruara në procesverbalet përkatëse, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për Titullarin e Autoritetit Kontraktor

1. Për z. V.T, me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë Lezhë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për këto arsye:

-për mos anulimin në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor të 2 procedurave të prokurimit me shkelje ligjore dhe me efekte financiare për vlerën **4,124,202 lekë dëm ekonomik** në objektet “Rikonstruksion i Objektit 4-katësh në bashkëpronësi sheshi”Beslidhja” në qytetin e Lezhës” dhe “Rikualifikim i lulishtes së qendrës së qytetit të Lezhës” për vitin 2014, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, 33, pika 5 “Vlerësimi i Ofertave” nën pika 5.5 të DST” pika”c”, me Kreun V pika 1, 2 të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”.

-për mos anulimin në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor të 4 procedurave të prokurimit me mangësi ligjore dhe efekte financiare për vlerën **6,409,473 lekë mos efektivitet të fondeve publike** në objektet: “Ndriçimi dhe sistemimi i rrugës hyrëse të Lezhës, segmenti Ura e Drinit –Rotondo, viti 2014”, “Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës viti 2014”, “Blerje karburanti për Bashkinë Lezhë për vitin 2015”, “Blerje artikuj ushqimorë për kopshte, konvikt e çerdhe për vitin 2015” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik”, Neni 43 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 3, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III “Dokumentet e tenderit” pika 3 “Informacione të veçanta”, germa”a” Kontratat për punë, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 64, pika 5.

Për anëtarët e njësisë së prokurimit:

2. B.M, Drejtore Juridike, në cilësinë përgjegjëse e njësisë prokurimit dhe në cilësinë e anëtares së KVO, për shkeljet e mëposhtme:

në cilësinë përgjegjëse e njësisë prokurimit

-për 4 raste me mangësi ligjore në procedurat e prokurimit të viteve 2013, 2014, 2015 konkretisht:

a. Në procedurat e prokurimit të llojit “Kërkesë për propozim” me objekt “Blerje pajisje, kompjutera për projektin Ndërtim i zyrës me një ndalesë në Bashkinë Lezhë, faza e dytë”, “Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Lezhë” viti 2013, janë evidentuar mangësi ligjore të përbashkëta si: Nuk është kryer analizimi dhe

dokumentimi i kostos së mallit që do të prokurohen, nuk janë evidentuar çmimet e bursës, për tenderin e karburantit, nga buletini i fundit APP, si dhe elementët fiskalë, nuk është dokumentuar ftesa e operatorëve ekonomikë, mungojnë deklaratat për konfliktin e interesit të KVO, nuk është bërë njoftimi i fituesit të tenderit me protokoll, nuk është bërë hedhja e njoftimit të lidhjes së kontratës në sistemin elektronik të APP si dhe nuk është bërë arkivimi i dosjes së tenderit dhe inventarizimi i saj me shkresë përcjellëse për arkivim, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu I, “Organizimi i Prokurimit Publik” pika 3 Kreu III “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, germa ”b”, “Kontratat e mallrave”, Kreu VI “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, prokurim me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, Kreu V, pika 1, germa ”a”, si dhe nenit 7 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

b. Në procedurën e prokurimit “Rikonstrukcion zyrash (mobilim,infrastrukturë), Loti 2 “Shërbim interneti” për vitin 2013, lloji i procedurës “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” janë ndryshuar kushtet fillestare të njoftimit të kontratës në objekt “Rikonstrukcion i rrjetit të brendshëm kompjuterik,Radio Link dhe Blerje Kompjuteri”. në kundërshtim me në VKM nr.1, datë 10.01.2007“Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV”Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”, pika 5, germa “a”.

c. Në procedurën e prokurimit “Blerje artikuj ushqimorë për kopshte, konvikt e çerdhe për vitin 2015”, janë evidentuar mangësi ligjore si: Nuk ka kërkesa e sektorit të interesuar për kryerjen e shpenzimit, nuk ka urdhër për ngritjen e grupit të punës për hartimin e preventivit specifikimeve teknike dhe fondit limit,nuk ka miratim të treguesve teknikë nga titullari i Autoritetit Kontraktor, kriteret e veçanta për kualifikim nuk janë hartuar nga specialist, nuk është përcaktuar sasia e ushqimeve që parashikohet të blihen në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 59.

Në cilësinë anëtare e komisionit të vlerësimit të ofertave,

-për 2 raste shkelje ligjore në procedurat e prokurimeve publike të vitit 2014, me efekte financiare për vlerën **4,124,202 lekë dëm ekonomik** konkretisht:

a.Në procedurën e hapur të prokurimit “Rikonstrukcion i Objektit 4-katësh” viti 2014, është shkakuar dëm ekonomik në shumën 1,418,063 lekë si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues “Kthella sh.p.k” me vlerë 9,006,332 lekë dhe ofertës së skualifikuar “E.-M. sh.p.k” me ofertën më të ulët, me vlerë 7,588,269 lekë, (9,006,332 -7,588,269), pasi KVO gjatë vlerësimit të ofertave, ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “E.-M. sh.p.k” me ofertën më të ulët, në kundërshtim me pikën 5 “Vlerësimi i Ofertave” nën pika 5.5 të DST dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” pika”c”.

b. Në procedurën e hapur të prokurimit “Rikualifikim i lulishtes së qendrës së qytetit të Lezhës” viti 2014, është shkakuar dëm ekonomik në shumën 2,706,139 lekë si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues T.A.L. sh.p.k me vlerë 26,610,619 lekë dhe ofertës së skualifikuar “B...S”sh.p.k me vlerë 23,904,480 lekë(26,610,619 -23,904,480), pasi KVO gjatë vlerësimit të ofertave, ka skualifikuar

padrejtësisht operatorin ekonomik "B...S" sh.p.k me ofertën më të ulët, në kundërshtim me pikën 5 "Vlerësimi i Ofertave" nën pika 5.5 të DST dhe me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar "Për prokurimin publik", Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2.

3. N.K, juriste dhe në cilësinë e anëtarës së njësisë prokurimit,

-për 8 raste shkelje në procedurat e prokurimeve publike për vitet 2013, 2014, 2015 me mangësi ligjore të përbashkëta dhe me efekte financiare në vlerën **6,409,473 lekë mos efektivitet të fondeve publike** konkretisht:

a. Në procedurat e prokurimit të llojit "Kërkesë për propozim" me objekt "Blerje pajisje, kompjutera për projektin Ndërtim i zyrës me një ndalesë në Bashkinë Lezhë, faza e dytë", "Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Lezhë" viti 2013, janë evidentuar mangësi ligjore të përbashkëta si: Nuk është kryer analizimi dhe dokumentimi i kostos së mallit që do të prokurohen, nuk janë evidentuar çmimet e bursës, për tenderin e karburantit, nga buletini i fundit APP, si dhe elementët fiskalë, nuk është dokumentuar ftesa e operatorëve ekonomikë, mungojnë deklaratat për konfliktin e interesit të KVO, nuk është bërë njoftimi i fituesit të tenderit me protokoll, nuk është bërë hedhja e njoftimit të lidhjes së kontratës në sistemin elektronik të APP si dhe nuk është bërë arkivimi i dosjes së tenderit dhe inventarizimi i saj me shkresë përcjellëse për arkivim, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.1, datë 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu I, "Organizimi i Prokurimit Publik" pika 3 Kreu III "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta", germa "b", "Kontratat e mallrave", Kreu VI "Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, prokurim me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit", Kreu V, pika 1, germa "a", si dhe nenit 7 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat".

b. Në procedurën e prokurimit "Rikonstruksion zyresh (mobilim, infrastrukturë), Loti 2 "Shërbim interneti" për vitin 2013, lloji i procedurës "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit" janë ndryshuar kushtet fillestare të njoftimit të kontratës në objekt "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm kompjuterik, Radio Link dhe Blerje Kompjuteri" në kundërshtim me në VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, kreu IV "Llojet dhe përzgjedhja e procedurës", pika 5, germa "a".

c. Në procedurën e hapur të prokurimit "Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës" viti 2014, është krijuar **mos efektivitet i fondeve publike shumë 5,506,779 lekë** si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues "J...K" sh.p.k me vlerë 22,915,940 lekë dhe ofertës së skualifikuar Derveni/1 sh.p.k me vlerë 17,409,161 lekë, (22,915,940 -17,409,161) pasi njësisia e prokurimit gjatë vendosjes së kushteve të kualifikimit në DST ka aplikuar kushte të veçanta të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik, në kundërshtim me pikën 5 "Vlerësimi i Ofertave" nën pika 5.5 të DST dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" pika "c".

d. Në procedurën e hapur të prokurimit "Ndriçimi dhe sistemimi i rrugës hyrëse të Lezhës, segmenti Ura e Drinit-Rotondo" viti 2014, është shkaktuar **mos efektivitet të përdorimit të fondeve në shumë 902,694 lekë** nga modifikimin e paargumentuar i DST, si pasojë është krijuar diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues "J...K" sh.p.k me vlerë 33,341,150 lekë dhe ofertës së skualifikuar "K...A" sh.p.k me

vlerë 32,438,456 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik”, Neni 1”Objekti dhe qëllimi” pika 2.

e. Në procedurat e prokurimit “Blerje karburanti për Bashkinë Lezhë”, “Blerje artikuj ushqimorë për kopshte, konvikt e çerdhe”, “Blerje materiale ndërtimi për nevojat e Bashkisë Lezhë” për vitin 2015, janë evidentuar mangësi ligjore të përbashkëta si: Nuk ka kërkesa e sektorit të interesuar për kryerjen e shpenzimit, nuk ka urdhër për ngritjen e grupit të punës për hartimin e preventivit specifikimeve teknike dhe fondit limit, nuk ka miratim të treguesve teknikë nga titullari i Autoritetit Kontraktor, nuk janë hartuar nga specialist kriteret e veçanta për kualifikim, nuk është përcaktuar sasia e karburantit mbi bazën e mjeteve në dispozicion të Bashkisë dhe volumin e punës që parashikohet të realizohet në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 59.

4. O.S, ekonomiste në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit

-për 2 raste shkelje me mangësi ligjore të përbashkëta në procedurat e prokurimit të vitin 2013, konkretisht

-Në procedurat e prokurimit të llojit “Kërkesë për propozim” me objekt “Blerje pajisje, kompjutera për projektin Ndërtim i zyrës me një ndalesë në Bashkinë Lezhë, faza e dytë”, “Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Lezhë” viti 2013, janë evidentuar mangësi ligjore të përbashkëta si: Nuk është kryer analizimi dhe dokumentimi i kostos së mallit që do të prokurohen, nuk janë evidentuar çmimet e bursës, për tenderin e karburantit, nga buletini i fundit APP, si dhe elementët fiskalë, nuk është dokumentuar ftesa e operatorëve ekonomikë, mungojnë deklaratat për konfliktin e interesit të KVO, nuk është bërë njoftimi i fituesit të tenderit me protokoll, nuk është bërë hedhja e njoftimit të lidhjes së kontratës në sistemin elektronik të APP si dhe nuk është bërë arkivimi i dosjes së tenderit dhe inventarizimi i saj me shkresë përcjellëse për arkivim, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu I, “Organizimi i Prokurimit Publik” pika 3 Kreu III “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, germa ”b”, “Kontratat e mallrave”, Kreu VI “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, prokurim me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, Kreu V, pika 1, germa ”a”, si dhe nenit 7 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

5. A.D. Drejtor i Planifikimit dhe rregullimit të territorit, inxhinier në cilësinë e anëtarit të njësisë prokurimit,

-për 3 raste shkelje ligjore në procedurat e prokurimeve publike me efekte financiare për vlerën **6,409,473 lekë** mos efektivitet të fondeve publike dhe mangësi ligjore të përbashkëta për procedurat e prokurimit për vitet 2013, 2014, konkretisht:

a. Në procedurën e prokurimit “Rikonstrukcion zyresh (mobilim, infrastrukturë), Loti 2 “Shërbim interneti” për vitin 2013, lloji i procedurës “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” janë ndryshuar kushtet fillestare të njoftimit të kontratës në objekt “Rikonstrukcion i rrjetit të brendshëm kompjuterik, Radio Link dhe Blerje Kompjuteri” në kundërshtim me në VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV “Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”, pika 5, germa “a” .

b. Në procedurën e hapur të prokurimit “Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës” viti 2014, është krijuar **mosefektivitet i fondeve publike shumën 5,506,779 lekë** si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues Junik sh.p.k me vlerë 22,915,940 lekë dhe ofertës së skualifikuar “D...1” sh.p.k me vlerë 17,409,161 lekë, pasi njësia e prokurimit gjatë vendosjes së kushteve të kualifikimit në DST ka aplikuar kushte të veçanta të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik, në kundërshtim me pikën 5 “Vlerësimi i Ofertave” nën pika 5.5 të DST dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 2 ”Parimet e përzgjedhjes” pika”c”.

c. Në procedurën e hapur të prokurimit ”Ndriçimi dhe sistemimi i rrugës hyrëse të Lezhës,segmenti Ura e Drinit–Rotondo” viti 2014, është shkaktuar **mos efektivitet të përdorimit të fondeve në shumën 902,694 lekë** nga modifikimin e pa argumentuar i DST, si pasojë është krijuar diferencë midis ofertës së operatorit fitues “J...K“ sh.p.k me vlerë 33,341,150 lekë dhe ofertës së skualifikuar “K...A” sh.p.k me vlerë 32,438,456 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik”, Neni 1”Objekti dhe qëllimi” pika 2.

6. R.B, ekonomiste në cilësinë e anëtarit të njësisë prokurimit,

- për 4 raste shkelje ligjore me efekte financiare për vlerën **6,409,473 lekë** mos efektivitet të fondeve publike dhe mangësi ligjore të përbashkëta në procedurat e prokurimit për vitin 2014, 2015 konkretisht:

a. Në procedurën e hapur të prokurimit “Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës” viti 2014, është krijuar **mosefektivitet i fondeve publike në shumën 5,506,779 lekë** si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues Junik sh.p.k me vlerë 22,915,940 lekë dhe ofertës së skualifikuar “D...1” sh.p.k me vlerë 17,409,161 lekë, (22,915,940 -17,409,161) pasi njësia e prokurimit gjatë vendosjes së kushteve të kualifikimit në DST ka aplikuar kushte të veçanta të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik, në kundërshtim me pikën 5 “Vlerësimi i Ofertave” nën pika 5.5 të DST dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 2 ”Parimet e përzgjedhjes” pika”c”.

b. Në procedurën e hapur të prokurimit ”Ndriçimi dhe sistemimi i rrugës hyrëse të Lezhës,segmenti Ura e Drinit–Rotondo” viti 2014, është shkaktuar **mos efektivitet të përdorimit të fondeve në shumën 902,694 lekë** nga modifikimin e paargumentuar i DST, si pasojë është krijuar diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues “J...K“ sh.p.k me vlerë 33,341,150 lekë dhe ofertës së skualifikuar “K...A” sh.p.k me vlerë 32,438,456 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik”, Neni 1”Objekti dhe qëllimi” pika 2.

c. Në procedurat e prokurimit “Blerje karburanti për Bashkinë Lezhë, “Blerje materiale ndërtimi për nevojat e Bashkisë Lezhë” për vitin 2015, janë evidentuar mangësi ligjore të përbashkëta si: Nuk ka kërkesa e sektorit të interesuar për kryerjen e shpenzimit, nuk ka urdhër për ngritjen e grupit të punës për hartimin e preventivit specifikimeve teknike dhe fondit limit,nuk ka miratim të treguesve teknikë nga titullari i Autoritetit Kontraktor, nuk janë hartuar nga specialist kriteret e veçanta për kualifikim, nuk është përcaktuar sasia e karburantit mbi bazën e mjeteve në dispozicion të Bashkisë dhe sasia e materialeve që parashikohet të blihen në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 59.

7. E.M, inxhinier mekanik, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit

-për 2 raste me mangësi ligjore të përbashkëta në procedurat e prokurimit të vitit 2015, konkretisht: Në procedurat e prokurimit “Blerje karburanti për Bashkinë Lezhë”, “Blerje materiale ndërtimi për nevojat e Bashkisë Lezhë” për vitin 2015, janë evidentuar mangësi ligjore të përbashkëta si; Nuk ka kërkesa e sektorit të interesuar për kryerjen e shpenzimit, nuk ka urdhër për ngritjen e grupit të punës për hartimin e preventivit specifikimeve teknike dhe fondit limit, nuk ka miratim të treguesve teknikë nga titullari i Autoritetit Kontraktor, nuk janë hartuar nga specialist kriteret e veçanta për kualifikim, nuk është përcaktuar sasia e karburantit mbi bazën e mjeteve në dispozicion të Bashkisë dhe sasia e materialeve që parashikohet të blihen në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 59.

Për anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

8. P.S, ish-Nën Kryetar i Bashkisë Lezhë në cilësinë e Kryetarit të KVO,

9. P.M, financier në cilësinë e anëtarit të KVO,

10. B.B, ekonomist në cilësinë e anëtarit të KVO,

11. E.N, arkitekte në cilësinë e anëtarit të KVO,

-për 2 raste shkelje ligjore të përbashkëta në procedurat e prokurimeve publike të vitit 2014, me efekte financiare në vlerën **4,124,202 lekë dëm ekonomik**, konkretisht:

a. Në procedurën e hapur të prokurimit “Rikonstruksion i Objektivit 4-katësh” viti 2014, është shkakuar **dëm ekonomik në shumën 1,418,063 lekë** si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues “Kthella sh.p.k” me vlerë 9,006,332 lekë dhe ofertës së skualifikuar “E.M. sh.p.k” me ofertën më të ulët, me vlerë 7,588,269 lekë, (9,006,332 -7,588,269), pasi KVO gjatë vlerësimit të ofertave, ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “E.M. sh.p.k” me ofertën më të ulët, në kundërshtim me pikën 5 “Vlerësimi i Ofertave” nën pika 5.5 të DST dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” pika c”.

b. Në procedurën e hapur të prokurimit “Rikualifikim i lulishtes së qendrës së qytetit të Lezhës” viti 2014, është shkakuar **dëm ekonomik në shumën 2,706,139 lekë** si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues “T.A.L.” sh.p.k me vlerë 26,610,619 lekë dhe ofertës së skualifikuar “B...S” sh.p.k me vlerë 23,904,480 lekë (26,610,619 -23,904,480), pasi KVO gjatë vlerësimit të ofertave, ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “B...S” sh.p.k me ofertën më të ulët, në kundërshtim me pikën 5 “Vlerësimi i Ofertave” nën pika 5.5 të DST dhe ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 1 “Objekti e qëllimi” pika 2.

D. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 58 germa ç, c, b, a “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31/7/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, **kërkojmë kryetarit të Bashkisë Lezhë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe **marrjen e masës disiplinore**

“Vërejtje” deri në “Largim nga puna”_dhe për ata me kontratë “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për këta punonjës:

1. B.M., me detyrë *Drejtor Juridik*, për shkeljet e mëposhtme:

-për 4 raste me mangësi ligjore të përbashkëta në procedurat e prokurimit për vitet 2013, 2014,2015, në cilësinë e anëtares njësisë prokurimit, konkretisht:

a. Në procedurat e prokurimit me objekt *”Blerje pajisje, kompjutera për projektin Ndërtim i zyrës me një ndalesë në Bashkinë Lezhë, faza e dytë”, ”Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Lezhë”*.

b. Në procedurën e prokurimit në objektet *”Rikonstruksion zyrash (mobilim,infrastrukturë), Loti 2 “Shërbim interneti”, “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm kompjuterik, Radio Link dhe Blerje Kompjuteri”*,

c. Në procedurën e prokurimit *“Blerje artikuj ushqimorë për kopshte, konvikt e çerdhe për vitin 2015”*,

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për rregullat e prokurimit publik”*.

-për 2 raste shkelje ligjore në procedurat e prokurimeve publike të vitit 2014, me efekte financiare për vlerën 4,124,202 lekë dëm ekonomik, në cilësinë anëtare e komisionit të vlerësimit të ofertave, konkretisht:

a.Në procedurën e hapur të prokurimit *”Rikonstruksion i Objektit 4-katësh”* viti 2014, është shkakuar dëm ekonomik në shumën 1,418,063 lekë,

b. Në procedurën e hapur të prokurimit *”Rikualifikim i lulishtes së qendrës së qytetit të Lezhës”*viti 2014, është shkaktuar dëm ekonomik në shumën 2,706,139 lekë,

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik.,*

-për 2 raste shkelje ligjore në lidhjen e kontratave nr. 5/3 datë 04.01.2013 dhe nr. 11 datë 03.01.2014 me objekt: *“Për dhënien me qira kundrejt shërbimeve të ambienteve të Pallatit të Kulturës Lezhë, për televizionin “L.S.”*, në cilësinë e Drejtores Juridike të Bashkisë Lezhë.

-për 7 raste lidhje kontrate me të drejtë përdorimi të pronave të Bashkisë, pa vlera qiraje, për shoqata dhe degë të partive politike, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011, ndryshuar me VKM nr. 54 datë 5.2.2014 *”Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*.

2. N.K., me detyrë *juriste*, për shkeljet e mëposhtme:

-për 8 raste shkelje në procedurat e prokurimeve publike për vitet 2013, 2014, 2015 me mangësi ligjore të përbashkëta, me efekte financiare për vlerën 6,409,473 lekë mos efektivitet të fondeve publike, në cilësinë e anëtares së njësive prokurimit , konkretisht:

a. Në procedurat e prokurimit me objekt *”Blerje pajisje, kompjutera për projektin Ndërtim i zyrës me një ndalesë në Bashkinë Lezhë, faza e dytë”,”Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Lezhë”* viti 2013 ,

b. Në procedurën e prokurimit në objektet *”Rikonstruksion zyrash (mobilim, infrastrukturë), Loti 2 “Shërbim interneti”*për vitin 2013, *“Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm kompjuterik, Radio Link dhe Blerje Kompjuteri”* ,

c. Në procedurën e prokurimit “*Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës*” viti 2014, është krijuar mosefektivitet i fondeve publike shumën 5,506,779 lekë

d. Në procedurën e prokurimit “*Ndriçimi dhe sistemimi i rrugës hyrëse të Lezhës, segmenti Ura e Drinit–Rotondo*” viti 2014, është shkaktuar mos efektivitet të përdorimit të fondeve në shumën 902,694 lekë,

e. Në procedurat e prokurimit “*Blerje karburanti për Bashkinë Lezhë*”, “*Blerje artikuj ushqimorë për kopshte, konvikt e çerdhe*”, “*Blerje materiale ndërtimi për nevojat e Bashkisë Lezhë*” për vitin 2015,

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për rregullat e prokurimit publik*” dhe me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “*Për prokurimin publik*”, ndryshuar.

3. O.S, me detyrë *ekonomiste*, për shkeljet e mëposhtme:

-për 2 raste shkelje me mangësi ligjore të përbashkëta në procedurat e prokurimit të vitin 2013, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, konkretisht:

-Në procedurat e prokurimit me objekt “*Blerje pajisje, kompjutera për projektin Ndërtim i zyrës me një ndalesë në Bashkinë Lezhë, faza e dytë*”, “*Blerje karburanti për nevoja të Bashkisë Lezhë*” viti 2013 , në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar.

4. R.B, me detyrë *ekonomiste*, për shkeljet e mëposhtme:

-për 4 raste shkelje ligjore në procedurat e prokurimeve publike me efekte financiare për vlerën 6,409,473 lekë mos efektivitet të fondeve publike dhe mangësi ligjore të përbashkëta për procedurat e prokurimit për vitin 2014, 2015, në cilësinë e anëtarit të njësisë prokurimit, konkretisht:

a. Në procedurën e prokurimit “*Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës*” është krijuar mosefektivitet i fondeve publike shumën 5,506,779 lekë,

b. Në procedurën e prokurimit “*Ndriçimi dhe sistemimi i rrugës hyrëse të Lezhës,segmenti Ura e Drinit–Rotondo*” është shkaktuar mos efektivitet të përdorimit të fondeve në shumën 902,694 lekë ,

c. Në procedurat e prokurimit “*Blerje karburanti për Bashkinë Lezhë*”, “*Blerje materiale ndërtimi për nevojat e Bashkisë Lezhë*” janë evidentuar mangësi ligjore të përbashkëta,

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për rregullat e prokurimit publik*” dhe me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, ndryshuar.

-Për mangësi në blerjet e vogla në 2 raste, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit drejtpërdrejtë, në kundërshtim me UAPP nr. 2 datë 28.3.2013 “*Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla*”

- Për shkelje në nxjerrjet jashtë përdorimi të mjetit benz, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve të njësisë të sektorit publik*” .

5. E,M, me detyrë *supervizor pastrimi*, për shkeljet e mëposhtme:

-për 2 raste me mangësi ligjore të përbashkëta në procedurat e prokurimit të vitit 2015 në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, konkretisht: Në procedurat e prokurimit “*Blerje karburanti për Bashkinë Lezhë*”, “*Blerje materiale ndërtimi për nevojat e*

Bashkisë Lezhë” janë evidentuar mangësi ligjore të përbashkëta, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, neni 59. -për mos mbajtjen e situacioneve dhe proces verbaleve ditore për mbikëqyrjen e shërbimit të pastrimit të qytetit ndaj firmës sipërmarrëse për vitin 2013, 2014, 2015, në kundërshtim kërkesat e kontratës sipërmarrëse nr. 1720, datë 16.9.2011 dhe me rregulloren brendshme të bashkisë neni 65, miratuar në KB sipas vendimit nr. 35, datë 30.6.2010.

6. B.B, me detyrë *inspektor i taksave vendore,*

7. E.N, me detyrë *punonjëse e urbanistikës,*

për shkeljet e mëposhtme:

-për 2 raste shkelje ligjore në procedurat e prokurimeve publike të vitit 2014, me efekte financiare në vlerën 4,124,202 lekë dëm ekonomik, në cilësinë e anëtarit të KVO,, konkretisht:

a. Në procedurën e prokurimit “*Rikonstruksion i Objektivit 4-katësh*” viti 2014, është shkaktuar dëm ekonomik në shumën 1,418,063 lekë,

b. Në procedurën e prokurimit “*Rikualifikim i lulishtes së qendrës së qytetit të Lezhës*” viti 2014, është shkaktuar dëm ekonomik në shumën 2,706,139 lekë,

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

-për mos mangësi në planifikimin dhe realizimin si dhe në vjeljen e debitorëve, sipas kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” i ndryshuar.

8. N.P, me detyrë *topograf dhe*

9. L.GJ, me detyrë *agronom, në cilësinë e specialistëve të ngarkuar me menaxhimin e aseteve dhe dhënien me qira të objekteve pronë të Bashkisë Lezhë,* për shkelje ligjore të përbashkëta, konkretisht:

-për mos përgatitjen e dosjeve për regjistrimin e 110 pronave të Bashkisë pranë ZVRPP Lezhë,

-për mos administrim të certifikatave të pronësisë për pronat e regjistruara në emër të Bashkisë nga ZVRPP Lezhë,

-për vonesa në azhurnimin e hartave kadastrale dhe mos evidentimin e ndryshimeve të zërave kadastrave me një regjistër të posaçëm dhe mos mbajtja e një kopje të dokumenteve në Arkiv,

-për mos marrjen e masave për lirim apo dhënien me qira sipas dispozitave ligjore të objekteve prona të Bashkisë të zëna nga qytetarët,

-për mungesë programi të trajtimit të pronave dhe aseteve nga shkrirja e njërive vendore pranë Bashkisë Lezhë, në kundërshtim me ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001

“*Për pronat e paluajtshme të shtetit*”, ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*”, të ndryshuar, me VKM nr. 500, datë 14.8.2001

“*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*” i ndryshuar.

Shënim: Mbështetur ne ligjin nr. 8652 datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" **do të kërkonim masë** për z. V.T, me detyrë ish-kryetar i bashkisë Lezhë, **por meqenëse nuk është në marrëdhënie pune, kjo masë quhet e ezauruar.** Po kështu për **P.S,** me detyrë **ish-Nën Kryetar i Bashkisë Lezhë** në cilësinë e Kryetarit të KVO (*nuk është në marrëdhënie pune*), për **P.M,** me detyrë **financier** në cilësinë e anëtarit të KVO (*pensionist*) dhe për **A.D,** me detyrë **Drejtor i Planifikimit dhe Rregullimit të Territorit (dorëhequr), për shkeljet e mëposhtme:**

10. V.T, me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë Lezhë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos anulimin në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor të 2 procedurave të prokurimit me shkelje ligjore dhe me efekte financiare për vlerën **4,124,202 lekë dëm ekonomik** në objektet "Rikonstruksion i Objektivit 4-katësh në bashkëpronësi sheshi" Beslidhja" në qytetin e Lezhës" dhe "Rikualifikim i lulishtes së qendrës së qytetit të Lezhës" për vitin 2014, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2, 33, pika 5 "Vlerësimi i Ofertave" nën pika 5.5 të DST" pika "c", me Kreun V pika 1, 2 të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik".

-për mos anulimin në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor të 4 procedurave të prokurimit me mangësi ligjore dhe efekte financiare për vlerën **6,409,473 lekë mos efektivitet të fondeve publike** në objektet: "Ndriçimi dhe sistemimi i rrugës hyrëse të Lezhës, segmenti Ura e Drinit –Rotondo, viti 2014", "Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës viti 2014", "Blerje karburanti për Bashkinë Lezhë për vitin 2015", "Blerje artikuj ushqimorë për kopshte, konvikt e çerdhe për vitin 2015" në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar "Për prokurimin publik", Neni 43 "Kualifikimi i ofertuesve" pika 3, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, kreu III "Dokumentet e tenderit" pika 3 "Informacione të veçanta", germa "a" Kontratat për punë, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", neni 64, pika 5.

- për mos apelimin, sipas shkresës datë 16.7.2013 të juristes të bashkisë , të vendimit gjyqësor të shkallës parë Lezhë nr. 528 datë 12.7.2013, për vlerën 34,234,316 lekë fituar nga një subjekt juridik ndaj Bashkisë Lezhë, çka ka krijuar ndikim negativ në buxhetin e bashkisë Lezhë.

11. P.S, ish-Nën Kryetar i Bashkisë Lezhë në cilësinë e Kryetarit të KVO dhe

12. P.M, financier në cilësinë e anëtarit të KVO,
për shkelje ligjore të përbashkëta, konkretisht:

-për 2 raste shkelje ligjore në procedurat e prokurimeve publike të vitit 2014, me efekte financiare në vlerën **4,124,202 lekë dëm ekonomik,** konkretisht:

a. Në procedurën e hapur të prokurimit "Rikonstruksion i Objektivit 4-katësh" viti 2014, është shkakuar **dëm ekonomik në shumën 1,418,063 lekë** si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues "Kthella sh.p.k" me vlerë 9,006,332 lekë dhe ofertës së skualifikuar "E.M. sh.p.k" me ofertën më të ulët, me vlerë 7,588,269 lekë, (9,006,332 -7,588,269), pasi KVO gjatë vlerësimit të ofertave, ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik "E.M. sh.p.k" me ofertën më të ulët, në kundërshtim me pikën 5

“Vlerësimi i Ofertave” nën pika 5.5 të DST dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 2 ”Parimet e përzgjedhjes” pika”c”.

b. Në procedurën e hapur të prokurimit ”Rikualifikim i lulishtes së qendrës së qytetit të Lezhës”viti 2014, është shkaktuar **dëm ekonomik në shumën 2,706,139 lekë** si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues “T.A.L.” sh.p.k me vlerë 26,610,619 lekë dhe ofertës së skualifikuar “B...S”sh.p.k me vlerë 23,904,480 lekë(26,610,619 -23,904,480), pasi KVO gjatë vlerësimit të ofertave, ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “B...S” sh.p.k me ofertën më të ulët, në kundërshtim me pikën 5 “Vlerësimi i Ofertave” nën pika 5.5 të DST dhe ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar , neni 1 ”Objekti e qëllimi” pika 2.

13. A.D, Drejtor i Planifikimit dhe Rregullimit të Territorit, për shkeljet e mëposhtme:

-për 3 raste shkelje ligjore në procedurat e prokurimeve publike me efekte financiare për vlerën 6,409,473 lekë mos efektivitet të fondeve publike dhe mangësi ligjore të përbashkëta për procedurat e prokurimit për vitet 2013, 2014, në cilësinë e anëtarit të njësisë prokurimit, konkretisht:

a. Në procedurën e prokurimit në objektet ”Rikonstruksion zyresh (mobilim, infrastrukturë), Loti 2 “Shërbim interneti” dhe “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm kompjuterik,Radio Link dhe Blerje Kompjuteri” në kundërshtim me në VKM nr.1, datë 10.01.2007“Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

b. Në procedurën e prokurimit “Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës” viti 2014, është krijuar mosefektivitet i fondeve publike shumën 5,506,779 lekë, në kundërshtim me pikën 5 “Vlerësimi i Ofertave” dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

c. Në procedurën e prokurimit ”Ndriçimi dhe sistemimi i rrugës hyrëse të Lezhës,segmenti Ura e Drinit–Rotondo” viti 2014, është shkaktuar mos efektivitet të përdorimit të fondeve në shumën 902,694 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar .

-për shkelje në lejen zhvillimore “Godinë Banimi dhe Shërbimi 1-10 kate + 1 kat Podrum (Seksioni B-1)” Bashkia Lezhë, mbi llogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, ku nuk është paguar vlera 12,247,743 lekë dëm ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 107/204 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46, pika 2.

-për shkelje në objektet “Rikualifikimi i Qendrës së Qytetit Lezhë”, “Rikualifikimi i Lulishtes së Qendrës” dhe “Zgjerim i Urës mbi Lumin Drin, Ndriçim dhe Dekorim” Bashkia Lezhë, në projekt zbatimin dhe preventivin e punimeve të ndërtimit, janë preventivuar tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve të krahasuar me manualin teknik të çmimeve dhe rritjes fiktive të volumeve të punimeve në krahasuar me projektin e zbatimit të miratuar, në kundërshtim me, aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe fushën e prokurimit publik.

D.II. PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE

I përcillet për kompetencë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion pranë Këshillit të Ministrave, për nxjerrjen e shkallës së përgjegjesisë dhe marrjen e masave disiplinore për z. D.B. ish-Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik dhe ish-anëtarët e KPP, për shkeljet në vendimin e KPP nr. 485/2014, datë 08.8.2014, në shqyrtimin e procedurës së prokurimit "Tender i Hapur" në objektin "**Rikualifikim i qendrës së qytetit të Lezhës**", ku u konstatua se: KPP gjatë gjykimit në themel me vendimin e tij nr. 485/2014, për procedurën e prokurimit "**Tender i Hapur**" në objektin "**Rikualifikim i qendrës së qytetit të Lezhës**", ka skualifikuar padrejtësisht BOE "**C...I**" shpk & "**G...I**" shpk, me vlerën më të ulët ekonomike 150,134,486 lekë dhe i ka dhënë të drejtën e kualifikimit BOE "**T.A.L.**" shpk & "**J...K**" shpk, fitues për vlerën 183,635,094 lekë, çka ka shkaktuar diferencën për vlerën **33,500,608 lekë** (183,635,094-150,134,486).

Sipas KPP, BOE "**C...I**" sh.p.k. & "**G...I**" sh.p.k., nuk ka plotësuar kërkesën e veçantë për paraqitjen e "**certifikatave ISO të origjinës, për shtyllat, ndriçuesit dhe kabllot që do të vendosen në objekt**", kjo nuk qëndron pasi subjekti i ka paraqitur ato. Ky fakt është anashkaluar nga KPP, duke kaluar në arsyetimin e një kontrate tjetër të shoqërisë "**C...I**" sh.p.k. dhe distributorit "**E.C.**" sh.p.k.

KPP ka vepruar me dy standarte në gjykimin e kërkesës së sipërcituar, pasi ka pranuar se BOE "**T.A.L.**" sh.p.k. & "**J...K**" sh.p.k., e cila i ka paraqitur certifikatat, dhe nuk ka pranuar faktin që BOE "**C...I**" sh.p.k. & "**G...I**" sh.p.k. ka paraqitur certifikatat, që në fakt i ka paraqitur madje dhe me ofertë më të ulët ekonomike, çka duhej ti jepte prioritet kësaj të fundit, veprim në kundërshtim me nenin 2 "**Parimet e përzgjedhjes**" pika "c" e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar "**Për Prokurimin Publik**".

E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë dhe marrjen e masave, që do të marrë Bashkia Lezhë për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga auditimi i kryer, reflektimin e tyre në përmirësimin e proceseve të veprimtarisë ekonomiko-financiare, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në shërbim të komunitetit.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e dërguara dhe afatin e caktuar 6 muaj, në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "**Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit**", do të kryejmë auditim të veçantë, për ecurinë dhe nivelin e zbatimit të masave të rekomanduara.

Nga Bashkia Lezhë, nuk është kthyer përgjigje akoma, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, pasi nuk është ezauruar afati ligjor prej 20 ditë, pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Besim Bileri, Beqir Kuteli, Vasillaq Peci, Bashkim Shehu dhe Taulant Dervishaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Xhaferr Xhoxhaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT